



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 34, datë 27.03.2019**

**PËR  
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË MANUALIN E MBIKËQYRJES PËR  
PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**

***Në Manualin e Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:***

Titullit “Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave”, i shtohen fjalët “dhe Financimin e Terrorizmit”;

Në të gjithë përmbajtjen e Manualit, pas tekstit “parandalim pastrim paraje” apo shkurt “PPP”, shtohet “/financim terrorizmi” apo “/FT”.

Në të gjithë përmbajtjen e Manualit, fjalët “shoqëri”, “shoqëri sigurimi”, “sigurues”, zëvendësohet me fjalën “subjekt”. Raste përjashtimore kur nuk zëvendësohen janë në kapitullin e parë, pika 1.2 Historiku, nëntema Faktorët e rrezikut, dhe në Kapitullin 8, Ilustrim 10: Fjalori i termave, pasi ka kuptim specifik vetëm për shoqëritë e sigurimit, dhe jo edhe për subjektet e tjera.

Në të gjithë përmbajtjen e Manualit, pas fjalës “konsumatorë”, shtohet “/klient”.

Në kapitullin e parë, pika 1.2 Historiku, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

*“Subjektet që mbikëqyren nga Autoriteti me qëllim parandalimin e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit përcaktohen në nenin 3, gjerat e) dhe ë), të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, si dhe në nenin 3 të Rregullores 58, datë 30.06.2015, “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar, të cilët janë:*

- *Bursat dhe çdo subjekt tjetër (agjent, broker, shoqëri brokerimi, etj.) që ushtron veprimtari për emetimin, këshillimin, ndërmjetësimin, financimin dhe çdo shërbim tjetër që ka lidhje me tregtimin e titujve;*

- *Shoqëritë që merren me sigurimin e jetës ose risigurimit, agjentët apo ndërmjetësit e tyre, si dhe fondet e pensionit.”;*

Në kapitullin e parë, pika 1.2 Historiku, në nëntemën, Faktorët e Rrezikut, në hyrje të saj shtohet: *“Të gjitha subjektet janë të ekspozuara ndaj kërcënimit se mund të shfrytëzohet nga kriminelët në përfitim të tyre, me qëllim PP/FT.”*, ndërsa në mbyllje të saj shtohet: *“Edhe Fondet i Investimeve apo pensionet vullnetare mund të përdoren për të lehtësuar pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit si psh.: Konsumatori kërkon të riblejë ose shlyej një investim brenda një periudhe të shkurtër pas investimit fillestar ose para datës së pagimit pa një arsytim të qartë, në veçanti kur kjo rezulton me humbje financiare ose pagesa të tarifave të larta të transaksionit; Krijimi i shpesh të papritur i marrëdhënieve të ngjashme të biznesit, pa marrë parasysh vlerësimet ekonomike si p.sh hyrja në disa marrëveshje të anëtarësimit në fondet vullnetare të pensioneve brenda një periudhe të shkurtër kohe (me një ose më shumë shoqëri administrimi) etj.*

*Raste të tjera, në të cilat vërehen situata të dyshimta, që lidhen me tregun e titujve, janë psh. transferimi i fondeve në institucione të tjera financiare ose depozituese, të ndryshme nga ku janë pranuar këto fonde fillimisht dhe veçanërisht kur janë të përfshira shtete të ndryshme; Strukturimi i depozitave të klientit, bëhet në mënyrë të tillë që tërheqje ose blerje të instrumenteve monetare të realizohet nën një sasi të caktuar për të shmangur kërkesat e raportimit ose regjistrimit; Klienti përdor llogari personale/individuale për qëllime biznesi; kryhet pagesa për palë të treta me të cilët klienti nuk ka lidhje të dukshme etj.*

*Tipologjitë e keqpërdorimit në të gjitha subjektet, për të realizuar PP/FT, janë të trajtura me thellësisht në Ankeset përkatëse, bashkëngjitur Rregullores 58/2015.”*

Në kapitullin 2, pika 2.1, në fund të fjalisë së parë, fjala “*të siguruesve*”, ndryshohet me “*për subjektet e mbikëqyrura*”;

Në fjalinë e tretë, në fund të paragrafit të parë, togefjalëshi “*hasë industria e sigurimeve*” ndryshohet me “*hasin subjektet e mbikëqyrura*”;

Në kapitullin 2, pika 2.2, nëntema Elementet e Programit PPP/FT- “*Katër Shtyllat*”, pika e dytë (shtylla e dytë), “*togfjalëshi “agjentëve dhe brokerave të saj”*”, ndryshohet me “*bursës si dhe çdo subjekti tjetër që lidhet me tregun e titujve, shoqëritë e sigurimit të jetës ose risigurimit si dhe ndërmjetësit e tyre, dhe fondet e pensionit*”;

Në kapitullin 2, pika 2.2, nëntema Elementet e Programit PPP/FT- “*Katër Shtyllat*”, pika e tretë (shtylla e tretë), shprehja “*Një shoqëri, e cila*”, ndryshohet me “*Subjekti që*”;

Në kapitullin 2, pika 2.2, nëntema Elementet e Programit PPP/FT- “*Katër Shtyllat*”, pika e katërt (shtylla e katërt), shprehja “*agjentët dhe brokerat e saj*”, ndryshohet me “*të gjitha subjektet e lartpërmendura*”;

Në kapitullin 2, pika 2.3, në fund të paragrafit të parë, shtohet fjalia “*Më poshtë paraqitet cikli i inspektimit të siguruesit, i cili është i njëjtë me ciklin e inspektimit në subjektet e tjera*”;

Në kapitullin 3, pika 3.1, nëntema e parë, pika 2, paragrafi i tetë, shprehjes “*Volumin dhe numrin e policave me rrezik*”, i shtohet “*/transaksioneve*”.

Në kapitullin 5, pika 9, në fjalinë e fundit, shprehja “*punonjësit dhe brokerat*”, ndryshohet me “*punonjësit*”.

Në kapitullin 5, pika 5.1, nënpika 6, hiqet paragrafi i fundit.

Në kapitullin 5, pika 5.4, nënpika 3, si dhe pika 5.11, paragrafi i parë, shprehja “*në një shumë më të madhe se 1,000,000 Lekë, në përputhje me nenin 12, paragrafi 3 të Ligjit*”, ndryshohet me “*në shumën e përcaktuar në dispozitat e Ligjit*”

Në kapitullin 8, Ilustrim 3, paragrafi i parë ndryshohet si vijon: “*Nga AMF-ja mund të kryhet inspektim në bashkëpunim me DPPPP, por edhe, inspektim i plotë, veçmas nga Autoriteti, për PPP/FT. Inspektimi duhet të përfshijë procedurat e mëposhtme të drejtuara për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit*”;

Në kapitullin 8, Ilustrim 3, pika 1, paragrafi i dytë, shprehja “*1 milion Lekë*”, ndryshohet me “*vlerën e përcaktuar në Ligjin PPP/FT*”, gjithashtu po në këtë paragraf hiqet fjalia “*Kjo zbatohet vetëm për aplikantët ose mbajtësit e policave të cilët paguajnë në para fizike për primet e policave*”;

Në kapitullin 8, Ilustrim 5, ndryshohet titulli nga “*Off-site/On-site Jashtë terrenit/Në terren*”, bëhet “*On-site/në terren*”;

Në kapitullin 8, Ilustrim 7, Nëntema Faza I, ndryshohet sipas kësaj përmbajtje “*Faza e parë është faza që ezaurohet me përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga Rregullorja nr. 58, datë 30.06.2015 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar. Referuar Nenit 11, paragrafit 2, të rregullores 58/2015, subjektet kanë detyrimin të raportojnë pranë Autoritetit mbi baza vjetore të dhënat e kërkuara sipas Anekseve 4 dhe 5, brenda 30 ditëve pas mbylljes së vitit kalendarik.*

- Aneks-i 4 ka të bëjë me kategorizimin e klientëve sipas rrezikut, kategorizimin e transfertave si dhe çdo të dhënë shtesë mbi subjektet që i nënshtrohen ligjit mbi pastrimin e parave;
- Aneks-i 5 është “Pyetësor për Parandalimin e Pastrimit të Parave (PPP)/ Parandalimin e Financimit të Terrorizmit (PFT)”. Ky pyetësor ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë përfshin informacion të përgjithshëm për subjektin, ndërsa pjesa e dytë është pyetësori “Njih klientin tënd (NKT) / kërkesa për Parandalimin e Pastrimit të Parave (PPP) / për Parandalimin e Financimit të Terrorizmit (PFT).

Tabelat ilustruese të matjes së riskut sipas formularëve të vetëvlerësimit depozituar pranë AMF-së, gjendet në Udhëzuesin “Për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit”, bashkëngjitur Rregullores.

Udhëzuesi “Për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit”, përcakton mënyrën e matjes së rreziqeve përkatëse, duke u bazuar mbi faktorët e jashtëm dhe të brendshëm, nivelin e rrezikut për secilin faktor. Nëpërmjet këtij udhëzuesi synohet përcaktimi i nivelit të përgjithshëm të rrezikut për secilin subjekt, duke u bazuar në një matricë të riskut neto, i cili përcaktohet si një kombinim i nivelit të riskut të jashtëm dhe atij të brendshëm.

**Tabela : Matrica e vlerësimit të kriterit**

Risku i Jashtëm	Raportim në DPPP	I Lartë	Raportim në DPPP	Raportim në DPPP
	I Lartë	I Mesëm	I Lartë	I Lartë
	I Mesëm	I Ulët	I Mesëm	I Lartë
	I Ulët	I Ulët	I Ulët	I Mesëm
		I Ulët	I Mesëm	I Lartë
Risku i Brendshëm				

Në kapitullin 8, Ilustrim 7, Nëntema Faza III, ndryshohet ndryshohet titulli nga “Off-site/On-site Jashtë terrenit/Në terren”, bëhet “On-site/në terren”;

Në kapitullin 8, Ilustrim 7, Nëntema Faza III, pika 5, nëndarja në tabelë tetë, fjalia e parafundit, shprehja “1’000’000 Lekë, në përputhje me Nenin 12 paragrafi 3 të Ligjit PPP” ndryshohet me “shumën e caktuar në Ligjin PPP/FT”;

Në kapitullin 8, Ilustrim 7, Nëntema Faza III, titulli në tabelë, Kategorizimi i rrezikut në lidhje me konsumatorët dhe transaksionet, pika 2, shprehja “të kërkuara nga rregulloret, d.m.th. Nenet 7 dhe 8 të Ligjit Shqiptar PPP”, ndryshohet me “sipas Rregullores 58/2015”, ndërsa në të gjitha paragrafët e kësaj pike hiqen shprehjet: “shih Nenin 8, paragrafi 1 (f) i Ligjit PPP”, “(Neni 8, paragrafi 3, Ligji PPP)”, “(Neni 8, paragrafi 4, Ligji PPP)”, “Neni 8, paragrafi 5, Ligji PPP”.

Në kapitullin 8, Ilustrim 7, Nëntema Faza III, titulli në tabelë, Procedura e inspektimit, pika 2, shprehja “Siguruesit për konsumatorët”, ndryshohet me “klientëve”.

Në kapitullin 8, Ilustrim 7, Nëntema Faza III, titulli në tabelë, Raportimet e transaksioneve në para fizike (RTPF-ve), paragrafi 1, shprehja “prej 1,000,000 Lekë në përputhje me Nenin 12, paragrafi 3, të Ligjit PPP”, ndryshohet me “e caktuar në Ligjin PPP/FT”.

Në kapitullin 8, Ilustrim 8, Identifikimi i Rrezikut, hiqet shprehja, në fund të fjalisë “në lëshimin e policave dhe në grumbullimin e primit.”

Në kapitullin 8, Ilustrim 10: Fjalori i termave, bëhen këto ndryshime:

Në fund të paragrafit të parë shtohet shprehja “ dhe fondet e investimeve”;

Në fund të paragrafit të tretë, shtohet një paragraf i katërt me këtë përmbajtje: “Subjektet që mbikëqyren nga Autoriteti me qëllim parandalimin e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit janë:

- Bursat dhe çdo subjekt tjetër (agjent, broker, shoqëri brokerimi, etj.) që ushtron veprimtari për emetimin, këshillimin, ndërmjetësimin, financimin dhe çdo shërbim tjetër që ka lidhje me tregtimin e titujve;
- Shoqëritë që merren me sigurimin e jetës ose risigurimit, agjentët apo ndërmjetësit e tyre, si dhe fondet e pensionit.

Termi “Pastrimi i parave”, i shtohet “Termi “pastrim parash” përcaktohet në OPMLTF dhe AMLO dhe nënkupton një akt që synon të ketë efektin e bërjes së çdo pasurie:

- (a) që janë të ardhurat e fituara nga komisioni i ndonjë veprë të parashikueshme sipas ligjeve të Shqipërisë, apo ndonjë sjelljeje të tillë që nëse do të kishte ndodhur në Shqipëri do të përbënte një kundërvajtje sipas ligjeve Shqiptare; ose
- b) që në tërësi ose pjesërisht, drejtpërdrejt ose tërthorazi, përfaqëson të ardhura të tilla, duke i bërë që të mos shfaqen si të tilla.”;

Termi “Financim Terrorizmi”, i shtohet “Termi “financimi i terrorizmit” përcaktohet në OPMLTF dhe AMLO dhe do të thotë:

(a) sigurimi ose grumbullimi, me çdo mjet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çdo prone:

(i) me qëllim që të përdoret prona; ose

(ii) duke ditur se prona do të përdoret, në tërësi ose pjesërisht, për të kryer një ose më shumë akte terroriste (pavarësisht nëse prona përdoret për raste të tilla);

(b) vënien në dispozicion e çdo pasurie ose shërbime financiare (të lidhura), me çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në dobi të një personi që e di, ose që nuk e di nga pakujdesia, se është terrorist ose bashkëpunëtor me terroristët;

(c) grumbullimin e pasurisë ose kërkimin e shërbimeve financiare (të lidhura) në çdo mënyrë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në dobi të një personi që e di, ose që nuk e di nga pakujdesia, se është terrorist ose bashkëpunëtor terrorist.”;

Në fund të materialit, shtohen 5 (pesë) paragrafë të tjerë me këtë përmbajtje:

“**Shoqëri administruese**” është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, veprimtaria tregtare e vetme dhe e vazhdueshme e së cilës është themelimi dhe/ose administrimi i fondeve të investimit dhe të shoqërive të investimit, në përputhje me Ligjin nr.10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

“**Fond investimi**”, që është sipërmarrja me pjesëmarrje të hapur, e krijuar në bazë të një kontrate, nëpërmjet ofertës publike të kuotave, në përputhje me konceptin e përshkruar në nenin

54 dhe dispozitat e tjera të Ligjit nr.10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

**“Kujdestar”** është një bankë e licencuar, e nivelit të dytë, e caktuar nga shoqëria administruese, e cila, në bazë të një marrëveshjeje me shoqërinë administruese dhe me porosi të saj, kryen veprimtarinë si kujdestar në mënyrën e parashikuar nga Ligji nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”.

**“Depozitar”** është një bankë e licencuar, e nivelit të dytë, e caktuar nga shoqëria administruese, e cila, në bazë të një marrëveshjeje me shoqërinë administruese dhe me porosi të saj, kryen veprimtarinë si depozitar në mënyrën e parashikuar nga Ligji nr.10 198, datë 10.12.2009. Për qëllime të këtij ligji, depozitari ka të njëjtin kuptim me kujdestarin e përcaktuar në ligjin nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”.

**“Fond pensioni vullnetar”** është një grup asetesh në pronësi të anëtarëve të fondit të pensionit e parashikuar nga Ligji Nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.